



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

**BURSA STUDIMI NË HUNGARI, VITI AKADEMIK 2017-2018**

Në zbatim të programit të bashkëpunimit me Hungarinë në fushën e arsimit dhe shkencës, Qeveria e Republikës së Hungarisë, përmes **Fondacionit Publik Tempus**, shpall programin e bursave shtetërore për shtetasit e huaj, në kuadër të programit Stipendium Hungaricum, të cilat përfshijnë studimet e plota/të pjesshme universitare, pasuniversitare në fushën e kërkimit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë ose të Kërkimit të Hungarisë, për vitin akademik 2017-2018, sipas kategorive të ndara si më poshtë:

- **Studime të pjesshme në nivelin Bachelor/Master/doktoraturë (1-2 semestra).** Kandidatët e interesuar duhet të jenë të regjistruar dhe të kenë statusin e studentit në një nga Institucionet e Arsimit të Lartë të vendit të tyre. Kandidatët mund të aplikojnë vetëm për studime të nivelit që janë duke ndjekur në vendin e tyre. Studimet me kohë të pjesshme nuk janë të vlefshme për kurse përgatitore apo specializimi. Këto studime janë të vlefshme maksimumi për një vit akademik pa mundësi shtyrjeje të mëtejshme.
- **Studime të plota në nivelin Bachelor/Master (6 semestra).** Studimet me kohë të plotë janë programe që finalizohen me marrjen e një diplome bachelor ose master. Programet bachelor zgjasin nga 2-4 vite akademike ndërsa studimet Master nga 1.5 – 2 vite akademike. Preferohen aplikimet në fushat e studimit si vijon: Bujqësi, Inxhinieri, Ekonomi, Arte dhe Shkenca Natyrore. Studentët që aplikojnë për kurse Master duhet të përfunduar studimet Bachelor dhe të kenë diplomën përkatëse për këtë nivel studimesh.
- **Studime Doktorale PHD, program i plotë (2+2 vite akademike).** Në përputhje me legjislacionin aktual në Hungari, kohëzgjatja e studimeve të doktoraturës është 8 semestra. Studimet doktorale përbëhen nga dy faza të ndryshme: e para është një periudhë 2 vjeçare që shërben për trajnim profesional dhe kërkim, ndërkohë që periudha e dytë shërben për realizimin e kërkimit dhe dizertacionin. Në përfundim të fazës së parë studentët janë të detyruar t'i nënshtrohen një provimi që synon të masë progresin arsimor dhe kërkimor. Kandidatët që aplikojnë për këto studime duhet të kenë një diplomë të nivelit Master.

Për të gjitha nivelet e studimit kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e nivelit të njohurive të gjuhës të përcaktuara nga programi i studimit për të cilin do të aplikojnë.

Kandidatët, do të bëjnë fillimisht aplikimin ONLINE i cili do të jetë i hapur nga mesi i Janarit 2017.

Sugjerohet që të gjithë kandidatët përveç aplikimit ONLINE duhet të dorëzojnë kopjet origjinale të dokumentacionit me postë në Drejtorinë e Integritimit dhe Projekteve për këto

bursa studimi deri në datën **5 Mars 2017**, që është edhe afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit referojuni materialeve informativë që gjenden në adresat web-site:

[www.scholarship.hu](http://www.scholarship.hu;);

[http://www.studyinhungary.hu](http://www.studyinhungary.hu;);

[http://tka.hu/international-programmes/4133/information-for-applicants](http://tka.hu/international-programmes/4133/information-for-applicants;);

## **DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE**